



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.221, Datë 09.11.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e bordit nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 139/8 prot., datë 08.11.2021 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Tetor 2021”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) me shkresën e saj nr. 9588 prot., datë 02.11.2021, dhe me tonën nr. 286/9 prot., datë 04.11.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Tetor 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020 të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.
- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e

ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Tetor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Tetor 2021		Sipas aplikimit të FSHU sh.a.		Sipas Përlogaritjeve të ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	27.85	27.85
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	Leke/kWh	0.84	0.84
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	28.69	28.69
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	32.73	32.73

- Bazuar në çdo element të formulës përlogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikim, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Tetor 2021, të jetë 32.73 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 32.73 Lekë/kWh për muajin Tetor 2021.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.